



Prishtinë: 02.09.2021  
Kodi i ZRRE-së: V\_1395\_2021

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e ZRRE-së: ZRRE/DMK\_R\_2162\_04\_21 .

në seancën e mbajtur më datë 02.09.2021 nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit D.K, nga Suhareka si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij rekomandimi.
- II. **OBLIGOHET** KESCO që konsumatorit me shifër DPZ - 9048318 t'i ofrojë kontratë për pagesë me këste për periudhën dyzetë mujore (40) mujore.

### A r s y e t i m

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) është parashtruar ankesa nga parashtruesi V.B me shifër **DPZ – 9048318** me të cilën është kundërshtuar përgjigja e lëshuar nga KESCO lidhur me kontestimin e korrigjimeve plotësues nr. 51562DPZ-9048318 dhe nr.51563DPZ-9048318 të datës 26.03.2018.

Bordi i ZRRE-së, me qëllimit të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike e cila është iniciuar nga palët në kontest lidhur me pikën matëse të theksuar më lartë ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha dëshmitë e mbledhura për veprimet e ndërmarra nga palët në kontest lidhur me këtë pikë matëse.

Me datë 23.12.2012 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë inspektimin e grupit matës, kanë larguar nga matja grupin matës nr.70198463 me gjendje të energjisë aktive TL=10.43 kWh dhe TU=2.61 kWh, të energjisë reaktive TL=9.39 kVar dhe TU=2.39 kVar si dhe gjendja momentale e maxigrafit në TL=1.28 kW, si dhe kanë vendosur për matje grupin matës nr.35716393 me gjendje TL=00000,000 kWh dhe TU=00000,000 kWh, të energjisë reaktive TL=00000,000 kVar dhe TU=00000,000 kVar si dhe gjendja momentale e Maxigrafit në TL=00000,000 dhe TU=00000,000, si dhe konstantja llogaritëse C=15.

**Provë:** Procesverbali mbi montimin-demontimin - ndërrimin e grupit matës nr.009389 i datës 23.12.2012

Me datë 19.03.2014 bazuar në kërkesën e konsumatorit për rritjen e fuqisë ka lëshuar Pëlqimin Elektroenergetik (PEE) nr.2927 me të cilin konsumatorit i është lejuar rritja e fuqisë për 46kW, si dhe është kërkuar që furnizimi të mbetet sipas PEE nr.581 të datës 10.02.2012, por që të bëhet ndërrimi i TMRR-ve ekzistuese me TMRR të rinj të raportit 250/5A.

**Provë:** Pëlqimin Elektroenergetik nr.2927 i datës 19.03.2014



Me datë 09.10.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë inspektimin e grupit matës, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve grupin matës nr.35716393 ku shpenzimet e njehsorit aktiv janë TL=3004,71 kWh dhe TU=280,40 kWh, të energjisë reaktive TL=3883,20 kVar dhe TU=156,89 kVar, si dhe gjendja e Maxigrafit në TL=0,9668 dhe TU=0,0944. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar që është bërë ndërrimi i TMRR-ve sipas PEE nr.2927 dhe janë vendosur TMRR 250/5, andaj duhet të bëhet edhe ndërrimi i konstantës llogaritëse në CCP nga C=15, në C=50.

**Provë:** Raporti mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr.006460 i datës 09.10.2014

Me datë 08.02.2018 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë inspektimin e grupit matës, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të grupit matës nr.35716393 ku shpenzimet e njehsorit aktiv janë TL=4893,695 kWh dhe TU=473,458 kWh, të energjisë reaktive TL=6309,421 kVar dhe TU=209,942 kVar, si dhe gjendja e Maxigrafit në TL=0,1356 dhe TU=0,0868. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar po ashtu konstantat llogaritëse për energji aktive, ku konstanta llogaritëse është C=50, kurse për TMRR C=15. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar ne procesverbal që konstantja e TMRR-ve nga C=15 duhet të bëhet C=50.

**Provë:** Raporti mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr.052276 i datës 08.02.2018

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 26.03.2018 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjimet plotësuese nr.51562DPZ-9048318 dhe nr.51563DPZ-9048318 në vlerë financiare 5,463.50€.

**Provë:** Korrigjimet plotësuese nr.51562DPZ-9048318 dhe nr.51563DPZ-9048318 të datës 26.03.2018

Konsumatori me datë 16.04.2018 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar korrigjimin plotësuese nr. 51562DPZ-9048318 dhe nr.51563DPZ-9048318 të datës 26.03.2018, në vlerë prej 5,463.50.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit e datës 16.04.2018

Me datë 18.05.2018 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij duke theksuar se korrigjimi plotësues është bërë për faturat e periudhës 11/2014 deri në periudhën 01/2018 për shkak të gabimit në faturim përkatësisht gabimit të faturimit të konstantës së TMRR-ve.

**Provë:** Përgjigja e KESCO-s e datës 18.05.2018

Me datë 24.10.2018 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjën e lëshuar nga KESCO duke kundërshtuar korrigjimet plotësuese nr. 51562DPZ-9048318 dhe nr.51563DPZ-9048318 të datës 26.03.2018.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 24.10.2018

Bordi i ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga konsumatori dhe KESCO, ka vërejtur se:

Me datë 23.12.2012 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë inspektimin e grupit matës, kanë larguar nga matja grupin matës nr.70198463 me gjendje të energjisë aktive TL=10.43 kWh dhe TU=2.61 kWh, të energjisë reaktive TL=9.39 kVar dhe TU=2.39 kVar si dhe gjendja momentale e maxigrafit në TL=1.28 kW, si dhe kanë vendosur per matje grupin matës nr.35716393 me gjendje TL=00000,000 kWh dhe TU=00000,000 kWh, të energjisë reaktive TL=00000,000 kVar dhe TU=00000,000 kVar si dhe gjendja momentale e Maxigrafit ne TL=00000,000 dhe TU=00000,000, si dhe konstantja llogaritëse C=15.

**Provë:** Procesverbali mbi montimin-demontimin - ndërrimin e grupit matës nr.009389 i datës 23.12.2012

Me datë 19.03.2014 bazuar në kërkesën e konsumatorit për rritjen e fuqisë, KEDS ka lëshuar PEE-në nr.2927 me të cilin konsumatorit i është lejuar rritja e fuqisë për 46kW si dhe është kërkuar që furnizimi të mbetet sipas PEE nr.581 të datës 10.02.2012, por që të bëhet ndërrimi i TMRR-ve ekzistuese me TMRR te rinj te raportit 250/5A.

**Provë:** Pëlqimi Elektroenergjetik nr.2927 i datës 19.03.2014



Me datë 09.10.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë inspektimin e grupit matës, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve grupin matës nr.35716393 ku shpenzimet e njehsorit aktiv janë TL=3004,71 kWh dhe TU=280,40 kWh, të energjisë reaktive TL=3883,20 kVar dhe TU=156,89 kVar si dhe gjendja e maxigrafit në TL=0,9668 dhe TU=0,0944. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar që është bërë ndërrimi i TMRR-ve sipas PEE nr.2927 dhe janë vendosur TMRR 250/5, andaj duhet të bëhet edhe ndërrimi i konstantës llogaritëse në CCP nga C=15, në C=50.

**Provë:** Raporti mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr.006460 i datës 09.10.2014

Me datë 08.02.2018 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë inspektimin e grupit matës, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve grupin matës nr.35716393 ku shpenzimet e njehsorit aktiv janë TL=4893,695 kWh dhe TU=473,458 kWh, të energjisë reaktive TL=6309,421 kVar dhe TU=209,942 kVar si dhe gjendja e Maxigrafit në TL=0,1356 dhe TU=0,0868. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar po ashtu konstantat llogaritëse për energji aktive, ku konstanta llogaritëse është C=50, kurse për TMRR C=15. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal që konstantja e TMRR-ve nga C=15 duhet të bëhet C=50 përkatësisht Cr=15 dhe Cm=15 dhe duhet të jetë Cr=50 dhe Cm=50.

**Provë:** Raporti mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr.052276 i datës 08.02.2018

Bazuar në analizën e bërë rrjedhës së energjisë elektrike aktive dhe transaksioneve të konsumatorit vërehet se konsumatori ka lexim të rregullt të pikës matëse. Sipas analizës së bërë rrjedhës së energjisë elektrike aktive dhe transaksioneve të konsumatorit vërehet se konsumatori me grupin matës nr.35716393 energjinë aktive ka pasur të llogaritur me konstantë llogaritëse C=50, por jo edhe energjinë reaktive si dhe fuqinë maksimale (maksigrafi), pasi që e njëjta është llogaritur me konstantë llogaritëse C=15, e që është dashur të llogariten me konstante C=50, e që edhe këtu është bërë gabim nga vet KESCO. Duhet theksuar se ky është gabim i vet KEDS dhe KESCO pasi sipas Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, OSSH është përgjegjës për leximin e pikave matëse, ndërsa Furnizuesi për faturimin e saj.

**Provë:** Rrjedha e energjisë elektrike dhe transaksionet

Në nenin 28, paragrafi 1 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji theksohet se: *“Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar e dhe për tarifën tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme)”*, por që duhet theksuar se në rastin e konsumatorit në fjalë, Furnizuesi nuk ia ka faturuar tërë energjinë e shpenzuar gjatë periudhës 11/2014 deri më 01/2018, pra nuk ia ka faturuar energjinë reaktive si dhe pjesën e fuqisë maksimale (maksigrafin) bazuar edhe në procesverbalet e grupeve matëse të cekura më lartë. Gjithashtu duhet theksuar se në nenin 28, paragrafi 3 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, thuhet se: *“Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”*, e që në rastin e konsumatorit në fjalë, me datë 26.03.2018 KESCO ka bërë korrigjimin shtesë, duke ia ngarkuar konsumatorit diferencën e pjesës së fuqisë maksimale (maksigrafin) dhe energjisë reaktive me konstantën llogaritëse C=50 nga e faturuara prej C=15.

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 26.03.2018 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjimet plotësuese nr.51562DPZ-9048318 dhe nr.51563DPZ-9048318 në vlerë financiare 5,463.50€ duke bërë korrigjimet e faturave për periudhën 11/2014 deri në periudhën 01/2018. BORDI i ZRRE-së ka analizuar korrigjimet e bëra dhe se vërtetohet se konsumatorit i janë bërë korrigjimet për konstanten e maksigrafit dhe energjisë reaktive nga konstantja C=15 në C=50 si rrjedhojë e rritjes së fuqisë, përkatësisht ndërrimit të TMRR-ve nga 75/5 në 250/5 dhe se konstaton se korrigjimi shtesë është i saktë.

**Provë:** Korrigjimet plotësuese nr.51562DPZ-9048318 dhe nr.51563DPZ-9048318 të datës 26.03.2018



Bordi i ZRRE bazuar në të gjitha shkresat, e veçanërisht bazuar në Raportin mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr.052276 i datës 08.02.2018, rrjedhën e energjisë elektrike aktive dhe transaksionet e konsumatorit konstaton se nga periudha 11/2014 e deri më 01/2018 konsumatorit në fjalë KESCO nuk ia ka faturuar tërë energjinë elektrike të shpenzuar, respektivisht nuk ia ka faturuar pjesën e fuqisë maksimale (maksigrafim) dhe energjisë reaktive sipas konstantës  $C=50$ , por sipas konstantës  $C=15$ , andaj ajo pjesë është shpenzuar nga konsumatori dhe si e tillë edhe duhet të faturohet si korigjim shtesë bazuar në nenin 28, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji. Por pasi që në rastin e konsumatorit, gabimi gjatë faturimit ka qenë i KESCO-s, atëherë KESCO duhet t'ia ofroj konsumatorit një marrëveshje pagese me këste për një periudhë dyzet mujore (40) mujore.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu. kryesues

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Lutfije Gashi, anëtar

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Konsumatorit: D.F (parashtruesi V.B)
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.